

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI;

Vlerëson veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Angazhimin institucional për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 159 auditimeve të ushtruara në 205 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

Adresimin e një numri total prej 4378 rekomandimesh për institucionet publike të audituara.

Vijimin e punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimit e pronës shtetërore dhe prokurimin publik.

Realizimin e auditimeve të posaçme për 97 subjekte të audituara lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga i cili ka rezultuar se janë pranuar 99% e rekomandimeve, rreth 70% e të cilave janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht nga institucionet e administratës shtetërore, duke treguar një përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi.

Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në bashkëpunim të ngushtë me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokurorinë e Përgjithshme dhe ato të rretheve, si dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke përcjellë pranë këtyre organeve 13 kallëzime penale.

Përmirësimin e kuadrit metodologjik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përfshirë këtu hartimin dhe miratimin e dokumenteve kryesore, që do të rregullojnë menaxhimin e cilësisë së auditimit në institucion, përfshirë politikën dhe udhëzuesin e menaxhimit të riskut të cilësisë, si dhe regjistrin e riskut. Të gjitha dokumentet e mësipërme të punës janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe janë përgatitur me asistencën e IDI (Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI).

Administrimit të 290 letrave dhe ankesave, ku rreth 30% e tyre kanë ngritur shqetësime që lidhen me vetëqeverisjen vendore.

Intensifikimin të përpjekjeve për të promovuar transparencën dhe ndërgjegjësimin qytetar, jo vetëm me publikimin e raporteve dhe dokumenteve periodike statistikore për punën audituese, por edhe me shtimin e rrjeteve të komunikimit me publikun nëpërmjet aktivizimit të profile në *facebook*, *instagram* dhe *linkedIn*, si dhe me publikimin e 1830 artikujve në shtypin e shkruar, median audiovizive *online* dhe kronika, etj.

Arritjes së rezultateve të rëndësishme në forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të institucionit, ku rezultoi se janë realizuar mesatarisht 26 ditë trajnimi për çdo auditues dhe 20 ditë për stafin joauditues, duke siguruar një nivel të lartë të përgatitjes dhe përditësimit të njohurive për përballimin e sfidave të auditimit modern.

Intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke konsoliduar marrëdhëniet me institucione supreme të auditimit të Kosovës, Norvegjisë, Turqisë dhe Maqedonisë së Veriut nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime të përbashkëta, takime teknike dhe auditime paralele, që kanë kontribuar në shkëmbimin e përvojës dhe rritjen e profesionalizmit të stafit.

Kuvendi kërkon që Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën në vijim të angazhohet edhe në këto drejtime:

1. Të përfundojë raportet e auditimeve të kontratave koncesionare, veçanërisht atyre që ndodhen në fazë përfundimi të afatit të zbatimit, lidhur me verifikimin e kostove të deklaruar nga operatorët privatë, përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe respektimin e detyrimeve fiskale e kontraktore.

2. Të përfundojë integrimin e metodologjisë për vlerësimin e dëmit ekonomik në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, duke siguruar që ndryshimet përkatëse të reflektojnë parimet e INTOSAI-t, përmes mundësimit të dokumentimit të plotë të provave audituese, zbatimit të një metode të unifikuar për raste të ngjashme, kujdesit profesional në evidentimin vetëm të dëmeve të matshme dhe të provueshme.

3. Të krijohet dhe të vihet në funksion një sistem formal, i strukturuar dhe gjithëpërfshirës për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet, që të mundësojë ndjekjen sistematike të të gjitha subjekteve publike të audituara dhe përditësimin e rregullt të statusit të zbatimit për rekomandimet e auditimeve të viteve të mëparshme, në mënyrë që të sigurohet një proces monitorimi efektiv, transparent dhe i harmonizuar me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të llogaridhënies publike dhe për të lehtësuar komunikimin me nënkomisionin parlamentar “Për auditimin e sektorit publik”.

4. Të përmirësohet cilësia e auditimeve të performancës, duke u orientuar drejt standardeve të vendeve të BE-së dhe në përputhje me rekomandimet e SIGMA-s nëpërmjet zgjerimit të gamës tematike të këtyre auditimeve dhe krijimit të historisë së ndërveprimit të institucioneve/agjencive publike.

5. Të zgjerojë auditimet në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë kontrollin e sigurisë së sistemeve, integritetin e të dhënave, funksionalitetin e platformave elektronike publike dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e sistemeve të IT.

6. Të intensifikojë dhe përshpejtojë procesin e dixhitalizimit të plotë të proceseve të punës, duke përdorur teknologjitë moderne për automatizimin, menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave të auditimit.

7. Të intensifikojë përpjekjet për plotësimin e vendeve vakante dhe të përqendrohet në optimizimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes ndarjes së drejtë të ngarkesës së auditimeve, trajnimeve të specializuara dhe zhvillimit të njohurive inovative në fushën e auditimit.

**KRYETAR
Niko Peleshi**

Miratuar në datën 6.11.2025